



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 150 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25 / 10 / 2023

**VENDIM**

Nr. 40 datë 25 / 10 / 2023

**PËR**

**KONTROLLIN SHTETEROR 5 VJECAR TE DIGES SE HEC BANJES**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.10.2023 mori në shqyrtim Raportin e përgatitur nga grupi i punës në lidhje me kontrollin 5 vjeçar të kryer në digën e HEC Banjes sipas kërkesave të nenit 37, pika 2 të VKM së mesipërme. Grupi i punës përbehej nga përfaqësuesit e MIE, AKBN, KKDM dhe KTPD.

Në baze të konstatimeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të grupit të punës të paraqitura në një raportin teknik si dhe bazuar në të dhënat e shfrytëzuesit të digës së HEC Banje të dhëna në aneksin 2 të këtij raporti, rezulton se trupi I digës së HEC Banje është në gjendje të qëndrueshme dhe elementet kryesore të saj janë në funksion dhe të monitoruara në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Pas diskutimeve të të gjithë antareve të pranishëm si dhe duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi, KKDM.

**VENDOSI**

1- Të miratoj Konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të punës bashkëlidhur këtij Vendimi në lidhje me kontrollin 5 vjeçar shtetëror të digës dhe rezervuarit të HEC Banjës

2- Ti kërkoj kompanisë Devolli HP si shfrytëzues i digës dhe rezervuarit të HEC Banjës

- Të marre masat e duhura për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga grupi i punës në lidhje me instalimin e sistemeve të alarmit në digë dhe rrjetet e tyre të transmetimit në zonat urbane poshtë tyre duke u bazuar në nenin 28 dhe 35 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e digave dhe dambave" dhe Udhëzimit Nr. 248, datë 28.01.2000 të gjashtë Ministrive në lidhje me planet e alarmit si dhe hartat e përmbajtjeve në rastet e prurjeve maksimale apo prishjes së mundshme të digës;
- Të dërgoj pranë SKDM një informacion në lidhje me qëndrueshmërinë e sistemit notues PV të instaluar përpara veprës së marrjes së ujit, standarteve teknike për operimin dhe monitorimin e sistemit si dhe ndikimeve të këtij sistemi në funksionimin dhe operimin e sistemit të marrjes së ujit dhe sigurisë së elementeve kryesore të digës dhe rezervuarit të dhëna në nenin 3 të VKM së mësipërme. Duke qenë se ky sistem është në kuadrin e një projekti kërkimor - shkencor, Shfrytëzuesi i digës mund të jap një informacion të zgjeruar në raportin vjetor për vitin 2023.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Të pregatit një raport teknik në lidhje me procesin e sedimentimit dhe sjelljes së mbetjeve të ngurta në rezervuar ku përmes matjeve të kryera deri më sot, të analizohen shkaqet e mbushjes me mbetjet e ngurta, trendi i mbushjes së rezervuarit për vitet e ardhme, masat që do të merren për zvogëlimin e trendit të derisotem si dhe për monitorimin e sedimenteve në të ardhmen.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI